




KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2027-2029

DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA

KOMUNA PEJË

QERSHOR

2026

Përmbajtja

I. Hyrje

II. Deklarata e Komunës në lidhje me prioritetet strategjike zhvillimore

III. Korniza Fiskale

3.1 Korniza makroekonomike komunale

3.2 Tendenca e të hyrave komunale dhe parashikimet 2027-2029

3.3 Donatorët e jashtëm

3.4 Tendenca e shpenzimeve komunale dhe parashikimet 2027-2029

3.5 Politikat e reja fiskale dhe buxhetore

3.6 Shtojca - Investimet kapitale

I.HYRJE

Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB) 2027-2029 është dokumenti kryesor strategjik dhe planifikues financiar i Komunës së Pejës, i cili hartohet dhe miratohet në përputhje me kornizën ligjore në fuqi dhe shërben si bazë për planifikimin e buxhetit komunal në periudhën afatmesme.

Ky dokument paraqet projeksionet e të hyrave dhe shpenzimeve komunale për periudhën 2027-2029, përcakton prioritetet zhvillimore të komunës dhe krijon bazën për shpërndarjen e qëndrueshme, transparente dhe efikase të resurseve financiare në funksion të realizimit të objektivave strategjike dhe përmirësimit të mirëqenies së qytetarëve.

Korniza Afatmesme Buxhetore siguron ndërlidhjen ndërmjet planifikimit strategjik dhe procesit buxhetor, duke mundësuar që prioritetet e përcaktuara në dokumentet strategjike, programet zhvillimore dhe planet sektoriale të komunës të reflektohen në planifikimin dhe alokimin e mjeteve buxhetore.

Hartimi i këtij dokumenti realizohet në përputhje me **Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë**, si dhe me **Qarkoren Buxhetore Komunale 2027/01 të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve**, e cila përcakton orientimet kryesore, kufijtë buxhetorë dhe parametrat për planifikimin afatmesëm të financave komunale.

Kjo Kornizë Afatmesme Buxhetore do të shërbejë si dokument bazë për përcaktimin e prioritetëve zhvillimore të Komunës së Pejës dhe për orientimin e investimeve dhe shpenzimeve publike gjatë periudhës 2027-2029, me qëllim të sigurimit të një zhvillimi të qëndrueshëm ekonomik e social, përmirësimit të infrastrukturës publike dhe ngritjes së cilësisë së shërbimeve për qytetarët.

Procesi i hartimit të **KAB-së 2027-2029** zhvillohet në përputhje me afatet dhe procedurat e përcaktuara nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe përfshin fazat kryesore të planifikimit, konsultimit, harmonizimit dhe miratimit të dokumentit, të cilat paraqiten në figurën në vijim.



Figura 1:Procesi i hartimit dhe miratimit të KAB-së 2027-2029

Pas fillimit të procesit të planifikimit buxhetor, Komuna e Pejës ka analizuar realizimin e të hyrave dhe shpenzimeve të periudhës paraprake, si dhe prioritetet dhe nevojat zhvillimore për periudhën afatmesme. Në këtë kuadër, udhëzimet dhe informacionet përkatëse janë shpërndarë në të gjitha drejtoritë komunale për përgatitjen e kërkesave buxhetore dhe projeksioneve të të hyrave.

Pas publikimit të Qarkores së Brendshme Buxhetore dhe Qarkores Buxhetore Komunale 2027/01 nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, drejtoritë komunale kanë hartuar kërkesat dhe projeksionet buxhetore në përputhje me kufijtë buxhetorë dhe prioritetet sektoriale. Gjatë procesit janë zhvilluar takime konsultuese dhe koordinuese për harmonizimin e kërkesave me kapacitetet financiare dhe objektivat zhvillimore të komunës.

Bazuar në kërkesat e pranuar, projeksionet e të hyrave, kufijtë buxhetorë dhe prioritetet strategjike të Komunës së Pejës, Drejtoria për Buxhet dhe Financa ka përgatitur Kornizën Afatmesme Buxhetore 2027-2029, e cila i paraqitet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim, përpara procedimit në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve.

II. Deklarata e Komunës në lidhje me prioritetet strategjike zhvillimore

Peja është një ndër vendbanimet më të vjetra në Kosovë, me origjinë që daton nga periudha ilire, dhe konsiderohet ndër qendrat më të rëndësishme historike të Dardanisë Antike. Komuna e Pejës shtrihet në një sipërfaqe prej **603 km²**, ndërsa qyteti i Pejës zë një sipërfaqe prej rreth **20 km²**.

Sipas regjistrimit të popullsisë të realizuar në vitin **2024**, Komuna e Pejës numëron **82,745 banorë**, krahasuar me rreth **96,450 banorë** të regjistruar në vitin 2011. Ky ndryshim demografik paraqet një faktor të rëndësishëm që merret në konsideratë gjatë planifikimit të politikave zhvillimore dhe organizimit të shërbimeve publike.

Qyteti i Pejës ndodhet në Rrafshin e Dukagjinit, në pjesën perëndimore të Republikës së Kosovës, në koordinatat gjeografike **42°40' gjerësi veriore** dhe **20°18' gjatësi lindore**. Lartësia mbidetare në territorin urban varion nga **450 deri në 520 metra**, ndërsa pika më e lartë në territorin e komunës është **Guri i Verdhë**, me një lartësi prej **2,522 metrash mbi nivelin e detit**.

Brenda territorit të komunës operojnë mbi **8,100 biznese aktive** nga gjithsej **9,805 biznese të regjistruara**, ku pjesa më e madhe i përket sektorit privat. Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, në komunën e Pejës regjistrohen mesatarisht rreth **500 biznese të reja çdo vit**, duke reflektuar një potencial të qëndrueshëm për zhvillimin e ekonomisë lokale dhe nxitjen e investimeve.

Peja dhe rrethina e saj paraqesin një potencial të konsiderueshëm për zhvillimin e turizmit dhe ekonomisë lokale. Në veçanti, **Bjeshkët e Nemuna**, si pjesë e Alpeve Shqiptare, përfaqësojnë një nga asetet më të rëndësishme natyrore dhe turistike të komunës. Pasuria e florës dhe faunës, peizazhet malore, lumenjtë, liqenet dhe trashëgimia e pasur kulturore e historike e bëjnë Pejën një destinacion të rëndësishëm turistik në nivel kombëtar dhe rajonal.



Figura 2. Pamje panoramike e qytetit të Pejës

Administrata e Komunës së Pejës është e organizuar në administratën qendrore dhe shtatë zyra lokale, të cilat sigurojnë ofrimin e shërbimeve administrative dhe publike për qytetarët në të gjithë territorin e komunës.

Vizioni zhvillimor i Komunës së Pejës është ndërtuar përmes një procesi gjithëpërfshirës konsultativ me akterët institucionalë, ekonomikë dhe shoqërorë, duke u mbështetur në dokumentet strategjike komunale dhe kombëtare. Ky vizion synon zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik e social, përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve, rritjen e konkurrueshmërisë së komunës, si dhe forcimin e kapaciteteve institucionale për ofrimin e shërbimeve publike cilësore.

Dokumentet Strategjike Kryesore

Dokumentet strategjike që orientojnë zhvillimin e Komunës së Pejës dhe përgatitjen e Kornizës Afatmesme Buxhetore **2027-2029** janë:

1. **Korniza Afatmesme e Shpenzimeve (KASH) 2027–2029**, e hartuar nga niveli qendror, e cila përcakton kufijtë dhe prioritetet buxhetore për periudhën afatmesme.
2. **Plani Zhvillimor Komunal (PZHK)**, i cili përcakton vizionin afatgjatë të zhvillimit të komunës.
3. **Plani Zhvillimor Urban (PZHU)**, që përcakton orientimet për zhvillimin urban dhe hapësinor.
4. **Plani i Veprimit për Punësim**, i fokusuar në përmirësimin e tregut të punës dhe rritjen e punësimit, veçanërisht për grupet e marginalizuara.
5. **Plani Operativ Emergjent Lokal (POEL)**, që përcakton masat për reagim dhe menaxhim të situatave emergjente dhe fatkeqësive.
6. **Plani për Menaxhimin e Mbeturinave**, që orienton politikat për trajtimin e qëndrueshëm të mbeturinave dhe mbrojtjen e mjedisit.
7. **Harta Zonale e Komunës së Pejës 2022-2030**, e cila ofron kornizën për planifikimin hapësinor dhe përdorimin racional të tokës në përputhje me potencialet zhvillimore të komunës.

Vizioni i Komunës për tri vitet e ardhshme është zhvillimi i Pejës si një qendër moderne dhe dinamike, e orientuar drejt turizmit, urbanizmit bashkëkohor dhe ofrimit të shërbimeve publike efikase e cilësore. Komuna synon të integrohet në mënyrë aktive në proceset rajonale dhe ndërkombëtare, duke u zhvilluar si një qendër e rëndësishme e kulturës, arsimit, sportit dhe zhvillimit ekonomik, me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së jetës së qytetarëve.

Prioritetet Strategjike të Komunës për Periudhën 2027-2029

1. Forcimi i Ekonomisë Lokale dhe Krijimi i Mundësive për të Gjithë

Ky prioritet synon nxitjen e zhvillimit ekonomik lokal përmes:

- Përmirësimi të cilësisë së arsimit dhe infrastrukturës arsimore;
- Mbështetjes së sektorit të bujqësisë dhe blegtorisë;
- Zhvillimit të turizmit dhe hotelerisë;
- Përgatitjes së kuadrove profesionale sipas nevojave të tregut të punës;
- Mbështetjes së investimeve dhe iniciativave që kontribuojnë në zhvillimin ekonomik të komunës.

2. Përmirësimi i Shëndetit dhe Mirëqenies së Qytetarëve

Ky prioritet fokusohet në:

- Rritjen e cilësisë dhe qasjes në shërbimet shëndetësore;
- Mbështetjen e aktiviteteve rinore, sportive dhe kulturore;
- Përmirësimin e mirëqenies sociale dhe përfshirjes së qytetarëve.

3. Përmirësimi i Mjedisit dhe Zhvillimi i Infrastrukturës së Qëndrueshme

Ky prioritet përfshin:

- Investime në infrastrukturën rrugore;
- Përmirësimin e furnizimit me ujë dhe rrjeteve të kanalizimit;
- Zgjerimin e ndriçimit publik;
- Krijimin dhe mirëmbajtjen e hapësirave të gjelbra;
- Mbrojtjen dhe menaxhimin e qëndrueshëm të mjedisit.

4. Rritja e Sigurisë dhe Forcimi i Qeverisjes Lokale

Ky prioritet synon:

- Përmirësimin e sigurisë publike;
- Rritjen e bashkëpunimit ndërinstitucional;
- Krijimin e një mjedisi të sigurt për qytetarët dhe bizneset;
- Forcimin e sundimit të ligjit dhe rendit publik.

5. Ofrimi i Shërbimeve Efikase dhe Digjitalizimi i Administratës

Ky prioritet fokusohet në:

- Përmirësimin e cilësisë së shërbimeve komunale;
- Zgjerimin e shërbimeve elektronike për qytetarët;
- Digjitalizimin e proceseve administrative;
- Rritjen e transparencës dhe llogaridhënies institucionale;
- Rritjen e efikasitetit në ofrimin e shërbimeve publike.

Pesë prioritetet strategjike të Komunës së Pejës për periudhën **2027-2029** do të mbështeten përmes burimeve financiare të planifikuara në Kornizën Afatmesme Buxhetore, investimeve kapitale, fondeve të nivelit qendror dhe mbështetjes së partnerëve zhvillimorë. **Zbatimi i këtyre prioritetëve do të monitorohet dhe vlerësohet në mënyrë të vazhdueshme përmes mekanizmave të planifikimit dhe raportimit buxhetor, me qëllim sigurimin e realizimit të objektivave strategjike dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së jetës së qytetarëve të Komunës së Pejës.**

III. Korniza Fiskale Komunale

Ndonëse komunat nuk udhëheqin drejtpërdrejt politikën makroekonomike të vendit, zhvillimet ekonomike në nivel kombëtar ndikojnë në planifikimin dhe menaxhimin e financave komunale. **Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës së Pejës për periudhën 2027-2029 është hartuar në përputhje me Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) 2027-2029 dhe Qarkoren Buxhetore 2027/01 të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve.**

Zhvillimet makroekonomike në vend paraqesin bazën kryesore për planifikimin afatmesëm të buxhetit komunal. Sipas projeksioneve zyrtare të Qeverisë së Republikës së Kosovës, **ekonomia e vendit pritet të vazhdojë trendin e rritjes së qëndrueshme me normë reale prej 3.8% gjatë periudhës 2024-2029**, pas rritjes prej 3.2% të realizuar në vitin 2023.

Në të njëjtën kohë, **inflacioni parashihet të stabilizohet në nivelin 2.9%**, duke krijuar kushte më të favorshme për planifikimin afatmesëm të financave publike dhe realizimin e investimeve zhvillimore.

Tregues pozitiv paraqet edhe rritja e vazhdueshme e Bruto Produktit Vendor për kokë banori. **BPV për kokë banori pritet të rritet nga 5,554 euro në vitin 2023 në 8,240 euro në vitin 2029**, duke reflektuar zgjerimin gradual të aktivitetit ekonomik dhe rritjen e potencialit zhvillimor të vendit.

Në nivel lokal, Komuna e Pejës vazhdon të mbështesë zhvillimin ekonomik përmes përmirësimit të kushteve për biznes, investimeve në infrastrukturë dhe ofrimit të shërbimeve më cilësore për qytetarët dhe sektorin privat. **Numri i bizneseve të regjistruara në komunë pritet të arrijë në rreth 11,805 biznese gjatë periudhës 2027-2029**, duke dëshmuar potencial të qëndrueshëm për zhvillim ekonomik dhe zgjerim të bazës së të hyrave komunale.

Gjithashtu, numri i nxënësve dhe ndryshimet demografike mbeten faktorë të rëndësishëm që ndikojnë në planifikimin e grantit për arsim dhe në shpërndarjen e burimeve buxhetore komunale.

Bazuar në këta tregues ekonomikë dhe fiskalë, Komuna e Pejës synon të ruajë stabilitetin financiar, të rrisë efikasitetin e menaxhimit të burimeve publike dhe të sigurojë një rritje graduale të të hyrave vetanake gjatë periudhës 2027-2029, duke forcuar qëndrueshmërinë afatgjate të financave komunale.

Tabela 1: Indikatorët Ekonomik Komunal

Përshkrimi	2023 (vlerësim)	2024 (vlerësim)	2025 (vlerësim)	2026 (vlerësim)	2027 (vlerësim)	2028 (vlerësim)	2029 (vlerësim)
Indikatorët makroekonomik në Kosovë							
Rritja reale e BPV në %	3.2	3.8	3.8	3.8	3.8	3.8	3.8
Inflacioni në %	5	2.9	2.9	2.9	2.9	2.9	2.9
BPV për kokë banori, në euro	5.554	5.999	6.406	6.834	7.285	7.761	8.240
Indikatorët ekonomik komunal							
Popullsia e Komunës	96.450	96.450	82.745	82.745	82.745	82.745	82.745
Numri i bizneseve të regjistruara	10.308	10.805	11.305	11.805	11.805	11.805	11.805
Numri i nxënësve	17.426	16.958	16.457	16.457	16.457	15.909	15.750

Burimi: Korniza Afatmesme e Shpenzimeve, Qeveria e Kosovës, 2027-2029

Të dhënat e paraqitura në **Tabelën 1** tregojnë se ekonomia e Kosovës pritet të vazhdojë trendin e rritjes së qëndrueshme gjatë periudhës **2027-2029**, me normë reale të **BPV-së** prej **3.8%** dhe inflacion të stabilizuar në nivelin **2.9%**. Në nivel lokal, Komuna e Pejës karakterizohet nga një bazë e qëndrueshme demografike dhe një rritje graduale e numrit të bizneseve të regjistruara, gjë që krijon potencial për zgjerimin e aktivitetit ekonomik dhe rritjen e të hyrave vetanake komunale. Ndërkohë, trendi i rënies së numrit të nxënësve mbetet një faktor që duhet të merret parasysh gjatë planifikimit afatmesëm të shpenzimeve në sektorin e arsimit.

3.2 Tendanca e të hyrave komunale dhe parashikimi afat-mesëm 2027-2029


Të hyrat e Komunës së Pejës - grantet qeveritare, të planifikuara për periudhën e ardhshme afatmesme (2027-2029) në total, do të kenë ndryshime dhe rritje të qëndrueshme nga viti në vit, mesatarisht me rreth **4.79%** (ku në vitin **2027** rritja e granteve shënon **3.97%**, në vitin **2028** shënon **5.03%**, ndërsa në vitin **2029** arrin në **5.38%**). Krahasuar vitin e parë të planifikimit afatmesëm (**2027**) me vitin fillestar (**2024**), në total buxheti i komunës do të shënojë një rritje të konsiderueshme prej **31.37%**.

Plani për të hyrat vetanake komunale për periudhën e ardhshme afatmesme po ashtu shfaq një trend pozitiv: në vitin **2027** plani ka shënuar një rritje mjaft të lartë prej **12.07%** krahasuar me vitin **2026**, ndërsa për periudhën vijuese **2028-2029** rritja vazhdon në mënyrë më të moderuar, ku në vitin **2028** shënon një rritje prej **2.83%** krahasuar me vitin **2027**, dhe në vitin **2029** rritet edhe për **4.30%**. Këto lëvizje dhe stabilizime të ritmit vijnë për shkak të harmonizimit të mundësive reale për inkasim të të hyrave vetanake komunale, duke pasur parasysh edhe efektet e plota të futjes së tatimit në tokë si dhe zbatimin e politikave të reja tatimore.

Vlerësimi i bazës së re tatimore për tatimin në pronë, që filloi si proces sfidues në vitet e kaluara, ka bërë që baza tatimore të zgjerohet. Megjithatë, për të parandaluar problemet në inkasim dhe për të shmangur rëndimin e gjendjes ekonomike të qytetarëve dhe bizneseve si pasojë e inflacionit dhe luhatjes së të ardhurave të tyre, komuna ka aplikuar një planifikim të matur afatmesëm. Në këtë kuadër, vërehet një stabilizim i rritjes së granteve specifike për Arsim dhe Shëndetësi në një normë fikse prej saktësisht **3.00%** në vit për periudhën **2028-2029**.

Planifikimi i buxhetit afatmesëm në bazë të burimit të hyrave duket si në grafikun 1 në vijim, dhe bazuar në të dhënat analitike të paraqitura në tabelën 2. Në këtë periudhë buxhetore ka vazhduar të planifikohet në mënyrë të rregullt edhe tatimi në pronë të paluajtshme në toka, si dhe financimi i qëndrueshëm nga shërbimet rezidenciale.

Grafikoni1:Përbërja e Buxhetit sipas Burimeve të Financimit



Analiza e strukturës së financimit tregon se burimi kryesor i buxhetit të Komunës së Pejës vazhdon të mbetet Granti i Përgjithshëm dhe grantet specifike për Arsim dhe Shëndetësi, të cilat përbëjnë pjesën më të madhe të financimit komunal. Në të njëjtën kohë, vërehet një trend pozitiv i rritjes së të hyrave vetanake, veçanërisht nga tatimi në pronë, tatimi në tokë dhe të hyrat jo tatimore. Kjo rritje kontribuon në forcimin e qëndrueshmërisë fiskale të komunës dhe krijon mundësi shtesë për financimin e prioritetëve zhvillimore dhe investimeve kapitale gjatë periudhës **2027-2029**.

Tabela 2: Krahasimi i Buxhetit sipas Burimeve të Financimit

Gjithsejt të hyrat vetanake	5,365,017.00	5,921,309.55	6,183,551.00	6,929,933.00	7,126,377.00	7,432,934.01
Granti i përgjithshëm	13,903,064.00	16,409,787.00	17,183,146.00	19,185,740.00	20,239,590.00	21,838,187.00
Teatri	129,567.00	204,527.00	250,696.00	264,782.00	279,345.00	294,709.00
Gjithsejt granti i përgjithshëm	14,032,631.00	16,614,314.00	17,433,842.00	19,450,522.00	20,518,935.00	22,132,896.00
Granti për arsim	10,323,643.00	12,810,169.00	13,310,859.00	13,038,791.00	13,429,955.00	13,832,854.00
Granti për shëndetësi	3,863,497.00	4,672,389.00	4,643,087.00	4,317,932.00	4,447,470.00	4,580,894.00
Financimi nga shërbimet rezidenciale		152,000.00	382,500.00	382,500.00	665,000.00	615,000.00
Gjithsejt GQ	28,219,771.00	34,248,872.00	35,770,288.00	37,189,745.00	39,061,360.00	41,161,644.00
Total buxheti	33,584,788.00	40,170,181.55	41,953,839.00	44,119,678.00	46,187,737.00	48,594,578.01
Vitet	2024	2025	2026	2027	2028	2029

Raporti Krahasues Ndërmjet Viteve (%)	2024/2025	2025/2026	2026/2027	2027/2028	2028/2029
Gjithsejt të hyrat vetanake	90.61%	95.76%	89.23%	97.24%	95.88%
Granti i përgjithshëm	84.72%	95.50%	89.56%	94.79%	92.68%
Granti për arsim	80.59%	96.24%	102.09%	97.09%	97.09%
Granti për shëndetësi	82.69%	100.63%	107.53%	97.09%	97.09%
Gjithsejt GQ	82.40%	95.75%	96.18%	95.21%	94.90%
Total buxheti	83.61%	95.75%	95.09%	95.52%	95.05%

Të dhënat e paraqitura në **Tabelën 2** tregojnë se buxheti i Komunës së Pejës ruan një trend të qëndrueshëm rritës gjatë periudhës **2027-2029**. Granti i përgjithshëm vazhdon të shënojë rritje të vazhdueshme, ndërsa grantet specifike për arsim dhe shëndetësi stabilizohen dhe rriten gradualisht në përputhje me projeksionet e **Qarkores Buxhetore 2027/01**. Në të njëjtën kohë, të hyrat vetanake komunale paraqesin trend pozitiv të rritjes, si rezultat i përmirësimit të inkasimit dhe zgjerimit të bazës tatimore. Raporti krahasues ndërmjet viteve dëshmon një ritëm të qëndrueshëm të rritjes së burimeve financiare, duke reflektuar stabilitet fiskal dhe duke krijuar bazë të mjaftueshme për realizimin e prioriteteve strategjike dhe zhvillimore të Komunës së Pejës gjatë periudhës afatmesme **2027-2029**.

Tabela 3: Planifikimi I të hyrave vetanake periudha 2027-2029

Kodi	Emërtimi i kodit	Realizimi 2025	Projekcioni 2026	Projekcioni 2027	Projekcioni 2028	Projekcioni 2029
1	2	3	4	5	6	7
16019	Zyra e Kryetarit	0	2	2	2	2
31	Granti i donatorëve të brendshëm	0	2	2	2	2
163	(I+II+III) Administr. dhe person.	137,495.00 €	179,988.00 €	194,271.08 €	210,136.09 €	222,153.39 €
16319	I. Administrata	137,495.00 €	179,988.00 €	194,271.08 €	210,136.09 €	222,153.39 €
50013	Taksa për çertifikata të lindjes	7,189.00 €	18,000.00 €	23,728.00 €	27,955.79 €	28,224.16 €
50014	Taksa për çertifikata të kurorëzimit	9,062.00 €	10,380.00 €	10,479.65 €	10,580.25 €	10,681.82 €
50015	Taksa për çertifikata të vdekjes	5,456.00 €	5,000.00 €	5,048.00 €	5,096.46 €	5,145.39 €
50016	Taksa për çertifikata tjera të ofiqarisë	100,678.00 €	130,000.00 €	131,248.00 €	142,507.98 €	153,876.06 €
50017	Taksa për ver.e dokum. të ndryshme	9,570.00 €	3,633.00 €	3,667.88 €	3,703.09 €	3,738.64 €
50018	Taksa për fotokopjim të dokumenteve	5,334.50 €	7,266.00 €	9,335.75 €	9,425.38 €	9,515.86 €
50019-50408	Taksa tjera administrative-30€ Qiraja nga objektet tjera-175.50€	205.50 €	5,709.00 €	10,763.81 €	10,867.14 €	10,971.46 €
50025	Taksa për shtetësi	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €
50109	Kompensimi I demeve nga kompensimi I sigurimit	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €
	-Të hyrat vetanake	137,495.00 €	179,988.00 €	194,271.08 €	210,136.09 €	222,153.39 €
16637	Inspekcioni	102,185.48 €	43,596.00 €	56,014.52 €	59,552.26 €	72,123.96 €
50104	Gjobat nga inspekt.-denim .mandatore	4,400.00 €	18,684.00 €	18,863.37 €	22,044.45 €	27,256.08 €
50205	Licencat për pranim teknik të lokalit	12,730.00 €	18,684.00 €	24,863.37 €	25,102.05 €	30,343.03 €
50501	Inspektimi i artikujve ushqimor	0.00 €	1,038.00 €	2,047.96 €	2,067.63 €	2,087.47 €
50505	Inspektimi veterinar - brenda vendit	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €
50507	Inspektimi higjienik sanitar	0.00 €	5,190.00 €	10,239.82 €	10,338.13 €	12,437.37 €
50102	Gjobat nga gjykatat	85,055.48 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €
	-Të hyrat vetanake	102,185.48 €	43,596.00 €	56,014.52 €	59,552.26 €	72,123.96 €
16795	Prokurimi	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €
50020	Taksa për pjesëmarrje në tender	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €
	-Të hyrat vetanake	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €
16919	Asambleja komunale	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €
50102	Gjobat nga gjykatat	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €
50101	Gjobat në trafik	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €

17519	Buxhet e financa	3,680,674.23 €	3,572,815.00 €	3,913,559.00 €	3,948,548.08 €	3,987,049.39 €
40110	Tatimi në pronë	2,218,775.42 €	2,635,918.00 €	2,827,022.00 €	2,855,292.00 €	2,869,568.00 €
	Tatimi në tokë	0.00 €	666,897.00 €	806,945.00 €	810,980.00 €	815,034.00 €
50001	Taksa e regjistrimit të automjeteve	313,085.00 €	270,000.00 €	279,592.00 €	282,276.08 €	302,447.39 €
50017	Taksa për verif. e dok. të ndryshme	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €
50019	Taksa tjera administrative	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €
50290	Licenca të tjera në afarizëm	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €
50101	Gjohat ne trafik	1,148,813.81 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €
	-Të hyrat vetanake	2,531,860.42 €	3,572,815.00 €	3,913,559.00 €	3,948,548.08 €	3,987,049.39 €
	Donacionet e jashtme	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €
	Qev.zvcrane	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €
180	(I+II) Punë komun.shërb. publike	59,954.52 €	70,672.00 €	84,851.17 €	85,665.74 €	86,488.13 €
18019	I. Infrastruktura Rrugore	59,954.52 €	70,672.00 €	84,851.17 €	85,665.74 €	86,488.13 €
50008	Taksa për parkim publik,kampim,repr.	19,370.00 €	30,288.00 €	42,079.48 €	42,483.45 €	52,891.29 €
50212	Licenca për rekl. publ.në prona publ.	38,059.74 €	40,384.00 €	42,771.69 €	43,182.29 €	43,596.84 €
61000	Të hyrat nga viti I kaluar	2,524.78 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €
	I .Të hyrat vetanake	59,954.52 €	70,672.00 €	84,851.17 €	85,665.74 €	86,488.13 €
	Donacionet e jashtme	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €
	Habitat - i	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €
18295	II. Emergjenca - zjarrëfikësat	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €
50502	Inspekt.i instalim.të zjarrit dhe komun.	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €
	Pëlq.e rreg.nga mbrojtja nga zjarri	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €
	Dhënja e pëlq.në dokum.Invest.tek.	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €
	Taksa për verif.e dokum.të ndryshme	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €
	-Të hyrat vetanake	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €
	Donacionet e jashtme	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €
	Qeveria Japoneze	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €
19595	Zyra lokale e komuniteteve	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €
47019	Bujqësi,pylltari,zhvillim rural	572,752.39 €	12,350.00 €	32,468.56 €	32,780.26 €	33,094.95 €
50012	Taksa për ndrrimin e destin. të tokës	496,564.39 €	11,227.00 €	31,334.78 €	31,635.59 €	31,939.29 €
500121	Taksat për zhavor	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €

500122	Pëlqimi për eksploat. e resurs. natyr.	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €
500123	Çertifikata për transportin e kafshëve	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €
50020	Taksa për pjesëmarrje në tender	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €
50203	Licenca për gurthyes dhe miniera	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €
50403	Të hyrat nga shitja e mallrave	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €
50405	Shfrytëzimi i pronës publike	2,160.00 €	1,123.00 €	1,133.78 €	1,144.67 €	1,155.65 €
	Gjohat nga pyjet	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €
	- Të hyrat vetanake	498,724.39 €	12,350.00 €	32,468.56 €	32,780.26 €	33,094.95 €
	- Participim i qytetarëve	74,028.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €
48019	Zhvillim ekonomik	31,159.15 €	40,000.00 €	45,384.00 €	45,819.69 €	56,259.56 €
50017	Taksa për verif.të dokum. të ndrysh.	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €
50019	Taksa tjera administrative	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €
50206	Licencat për shërbime profesionale	2,350.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €
50208	Licencat për transport të mallrave	5,396.00 €	10,000.00 €	15,096.00 €	15,240.92 €	20,387.23 €
502081	Vërtet.të ndrysh. dhe leje për itiner.	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €
50211	Lic. për shërbim të pijeve alkoolike	6,525.00 €	30,000.00 €	30,288.00 €	30,578.76 €	35,872.32 €
	I. Të hyrat vetanake	14,271.00 €	40,000.00 €	45,384.00 €	45,819.69 €	56,259.56 €
	Donacionet e jashtme	16,888.15 €				
650	(I+II) Gjeodezi dhe kadastër	1,186,830.85 €	909,762.00 €	1,088,711.72 €	1,189,441.75 €	1,345,860.39 €
65095	I. Shërbime kadastrale	232,449.00 €	410,570.00 €	521,727.47 €	526,736.06 €	576,792.72 €
50011	Taksa për regjistrimin e trashigimisë	97,901.00 €	145,000.00 €	183,608.00 €	185,370.64 €	192,150.19 €
50019	Taksa tjera administrative	7,457.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €
50032	Taksa për certifikata të pronësisë dhe kopje plani	66,680.00 €	140,000.00 €	151,344.00 €	152,796.90 €	164,263.75 €
50460	Regjistrimi i pengut	7,125.00 €	15,570.00 €	20,719.47 €	20,918.38 €	21,119.20 €
50504	Taksa për matjen e tokës në teren	53,286.00 €	110,000.00 €	166,056.00 €	167,650.14 €	199,259.58 €
	-Të hyrat vetanake	232,449.00 €	410,570.00 €	521,727.47 €	526,736.06 €	576,792.72 €
65495	II. Çështjet pronës. - juridike	954,381.85 €	499,192.00 €	566,984.24 €	662,705.69 €	769,067.67 €
50008	Taksa për parkim publik,kampim,rekr.	0.00 €	0.00 €	3,000.00 €	3,028.80 €	3,057.88 €
50212	Lic. për rekl.dhe publ.në prona publ.	122,195.00 €	113,000.00 €	114,084.80 €	120,180.01 €	121,333.74 €
50405	Shfrytëzimi i pronës publike	167,857.40 €	160,088.00 €	161,624.84 €	168,176.44 €	169,790.94 €
50408	Qiraja nga objektet publike	9,530.95 €	110,000.00 €	91,056.00 €	132,208.54 €	183,477.74 €

50008	Parkingu	0.00 €	116,104.00 €	197,218.60 €	239,111.90 €	291,407.37 €
50413	Të hyrat nga shitja e pasurisë	654,798.50 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €
	-Të hyrat vetanake	954,381.85 €	499,192.00 €	566,984.24 €	662,705.69 €	769,067.67 €
66100	Planifikimi urban dhe mjedisi	1,754,075.95 €	940,943.00 €	1,063,304.08 €	1,098,731.14 €	1,169,827.51 €
50009	Taksa komunale për leje ndërtimi	1,702,416.23 €	826,763.00 €	947,768.75 €	956,275.00 €	996,003.79 €
50026	Taksa për legalizimin e objekteve	51,659.72 €	114,180.00 €	115,535.33 €	142,456.14 €	173,823.72 €
	-Të hyrat vetanake	1,754,075.95 €	940,943.00 €	1,063,304.08 €	1,098,731.14 €	1,169,827.51 €
	Shëndetësia	133,943.50 €	110,903.00 €	141,967.67 €	143,330.56 €	144,706.53 €
74100	- Participim	133,943.50 €	110,903.00 €	141,967.67 €	143,330.56 €	144,706.53 €
	- Të hyrat vetanake	133,943.50 €	110,903.00 €	141,967.67 €	143,330.56 €	144,706.53 €
	Donacionet e jashtme Qeveria Italiane	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €
85019	Kulturë , Rini ,Sport	146,037.80 €	519.00 €	2,000.00 €	2,019.20 €	2,038.58 €
50008	Taksa për parkim publ.kampim , rekr.	0.00 €	519.00 €		0.00 €	0.00 €
50409	Participim - Biblioteka	1,902.80 €	0.00 €	2,000.00 €	2,019.20 €	2,038.58 €
	- Të hyrat vetanake	1,902.80 €	519.00 €	2,000.00 €	2,019.20 €	2,038.58 €
	Donacionet e jashtme - EU	144,135.00 €				
	Arsimi	232,181.09 €	302,000.00 €	307,399.20 €	310,350.23 €	313,329.59 €
	- Të hyrat vetanake	228,447.00 €	302,000.00 €	307,399.20 €	310,350.23 €	313,329.59 €
	- Donacionet e jashtme	3,734.09 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €
92570	- Arsimi parashk. - Qerdhet	174,157.00 €	250,000.00 €	249,900.00 €	252,299.04 €	254,721.11 €
	- Participim	174,157.00 €	250,000.00 €	249,900.00 €	252,299.04 €	254,721.11 €
	- Donacionet e jashtme	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €
	Save the children	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €
93540	- Arsimi fillor	3,734.09 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €
	- Participim	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €
	- Donacionet e jashtme	3,734.09 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €
	Save the children	3,734.09 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €
94740	- Arsimi i mesëm	54,290.00 €	52,000.00 €	57,499.20 €	58,051.19 €	58,608.48 €
	- Participim	54,290.00 €	52,000.00 €	57,499.20 €	58,051.19 €	58,608.48 €
	- Donacionet e jashtme	0.00 €				
	- Donacionet e jashtme EU	0.00 €				
	T O T A L I HV+ DONACIONE :	8,037,289.96 €	6,183,550.00 €	6,929,933.00 €	7,126,377.00 €	7,432,934.00 €

3.2.1 Të hyrat vetanake komunale

Të hyrat vetanake komunale përbëjnë një komponent të rëndësishëm të financimit të aktiviteteve dhe projekteve të Komunës së Pejës. Planifikimi i tyre për periudhën **2027-2029** është bazuar në trendin e realizimit të viteve paraprake, potencialin real të inkasimit, zhvillimet ekonomike lokale si dhe projeksionet e përcaktuara në **Qarkoren Buxhetore 2027/01**.

Sipas projeksioneve afatmesme, të hyrat vetanake komunale pritet të arrijnë në **6,929,933 €** në vitin **2027**, **7,126,377 €** në vitin **2028** dhe **7,432,935 €** në vitin **2029**. Krahasuar me buxhetin e përgjithshëm komunal, pjesëmarrja e tyre vlerësohet në rreth **15.71%** në vitin **2027**, **15.43%** në vitin **2028** dhe **15.30%** në vitin **2029**, duke dëshmuar një nivel të qëndrueshëm të vetëfinansimit komunal gjatë periudhës së planifikimit.


Struktura e të hyrave vetanake dominohet nga të hyrat tatimore, përkatësisht tatimi në pronë dhe tatimi në tokë, të cilat paraqesin burimin kryesor të financimit vetanak të komunës. Sipas projeksioneve, këto të hyra pritet të arrijnë **3,633,967 €** në vitin **2027**, **3,666,272 €** në vitin **2028** dhe **3,684,602 €** në vitin **2029**, duke përfaqësuar mbi gjysmën e të hyrave vetanake komunale.

Përveç tatimit në pronë, një kontribut të konsiderueshëm në gjenerimin e të hyrave japin Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mjedis, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, Drejtoria e Inspektionit, Drejtoria për Shërbime Publike, Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, si dhe drejtoritë e tjera komunale që ofrojnë shërbime administrative për qytetarët dhe bizneset. Këto të hyra realizohen kryesisht nga taksat për leje ndërtimore, legalizimet, rregullimi i tokës ndërtimore, licencat komunale, tarifat administrative, gjobat dhe pagesat për shërbime të ndryshme komunale.

Projeksionet për vitet **2027-2029** janë ndërtuar mbi parimin e planifikimit realist dhe të qëndrueshëm, duke reflektuar performancën aktuale të inkasimit dhe kapacitetet reale të gjenerimit të të hyrave. Komuna do të vazhdojë përmirësimin e administrimit të të hyrave vetanake, avancimin e bazës së të dhënave tatimore, rritjen e efikasitetit në arkëtimin e obligimeve ndaj komunës dhe zbatimin e masave ligjore për inkasimin e borxheve të papaguara.

Në periudhën afatmesme **2027-2029** pritet që rritja graduale e aktivitetit ekonomik, zhvillimi urban, zgjerimi i bazës tatimore dhe përmirësimi i performancës administrative të ndikojnë pozitivisht në nivelin e të hyrave vetanake, duke forcuar qëndrueshmërinë financiare dhe kapacitetin investues të Komunës së Pejës.

Grafikoni 2: THV sipas Burimit



Grafikoni paraqet trendin e të hyrave vetanake komunale gjatë periudhës **2025-2029**. Pas realizimit prej **8.04** milionë euro në vitin **2025**, për vitin **2026** është planifikuar një nivel prej **6.18** milionë euro, i bazuar në projeksionet reale të inkasimit dhe në kufijtë e përcaktuar buxhetorë. Për periudhën afatmesme **2027-2029** parashihet një rritje graduale e të hyrave vetanake, nga **6.93** milionë euro në vitin **2027** në **7.43** milionë euro në vitin **2029**. Kjo tendencë reflekton forcimin e kapaciteteve për mbledhjen e të hyrave, zgjerimin e bazës tatimore, si dhe një qasje të kujdesshme dhe të qëndrueshme në planifikimin buxhetor.

3.3 Donatorët e jashtëm (ndërkombëtarë)

Mbështetja financiare nga partnerët ndërkombëtarë dhe investimet përmes fondeve të donatorëve të jashtëm, duke përfshirë edhe participimet e qytetarëve në realizimin e projekteve të ndryshme kapitale dhe zhvillimore për Komunën e Pejës, përgjatë vitit **2025** ka arritur vlerën totale prej **370,318.11 €**.

Ky kontribut i rëndësishëm për zhvillimin lokal është siguruar falë bashkëpunimit me këto organizata dhe qeveri partnere:

- **BE – Unioni Evropian:** 193,362.21 €
- **Qeveria Zvicerane:** 163,576.75 €
- **Save the Children:** 7,006.53 €
- **Qeveria Italiane:** 6,372.62 €

Përveç këtyre fondeve, Komuna është në proces të realizimit të disa projekteve të tjera ekzistuese, të cilat ende nuk janë përmbyllur plotësisht nga ana e donatorëve. Po ashtu, Komuna e Pejës ka fituar Grantin e Performancës Komunale dhe aktualisht është në fazën e pritjes për fillimin e implementimit të tij. Paralelisht, qeveria lokale mbetet aktive dhe e hapur për të mirëpritur çdo donacion tjetër eventual që mund të negociohet gjatë kësaj periudhe.

3.4 Tendanca e shpenzimeve komunale dhe parashikimi i tyre afat-mesëm 2027-2029

Shpenzimet buxhetore të Komunës së Pejës për periudhën afatmesme **2027-2029** janë planifikuar në përputhje me kufijtë buxhetorë të përcaktuar në **Qarkoren Buxhetore Komunale 2027/01**, duke respektuar parimet e disiplinës fiskale, qëndrueshmërisë financiare dhe prioritetëve zhvillimore të komunës.

Buxheti komunal për periudhën afatmesme paraqet një **trend të qëndrueshëm rritës**, duke kaluar nga **41,953,839 €** në vitin 2026 në **44,119,678 €** në vitin 2027, **46,187,737 €** në vitin 2028 dhe **48,594,579 €** në vitin 2029. Kjo paraqet një rritje kumulative prej rreth **15.8%** gjatë gjithë periudhës së planifikimit.

Njëkohësisht, struktura e shpenzimeve vazhdon të dominohet nga kategoritë e **pagave dhe mëditjeve, investimeve kapitale**, si dhe **mallrave dhe shërbimeve**, të cilat së bashku përbëjnë pjesën më të madhe të buxhetit komunal.

Numri i pozitive të financuara nga buxheti komunal mbetet **2,222** gjatë gjithë periudhës 2027–2029, duke reflektuar stabilitet në strukturën organizative të komunës dhe duke mos paraparë zgjerim të administratës publike.

Pagat dhe mëditjet

Kategoria e pagave dhe mëditjeve vazhdon të përfaqësojë kategorinë më të madhe të shpenzimeve komunale.

Në vitin 2026 kjo kategori është planifikuar në shumën **21,322,669 €**, ndërsa për vitin 2027 është planifikuar në **21,481,142 €**, në vitin 2028 në **21,588,549 €**, ndërsa në vitin 2029 arrin në **21,696,493 €**.

Rritja e kësaj kategorie nuk lidhet me krijimin e vendeve të reja të punës, pasi numri i punëtorëve mbetet i pandryshuar (**2,222**), por është rezultat i:

- **obligimeve ligjore** që burojnë nga Ligji për Pagat në Sektorin Publik;
- **shtesave për përvojën e punës**, të cilat aplikohen çdo vit;
- harmonizimit të kostove të pagave sipas parametrave të përcaktuar nga **Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve**, veçanërisht për grantet specifike të arsimit dhe shëndetësisë.

Pavarësisht rritjes graduale të kësaj kategorie, pjesëmarrja e saj në totalin e buxhetit komunal vjen duke u zvogëluar lehtë gjatë viteve, si rezultat i rritjes më të shpejtë të investimeve kapitale.

Mallrat dhe shërbimet

Shpenzimet për mallra dhe shërbime janë planifikuar duke u bazuar në nevojat reale operative të drejtorive komunale dhe në parimin e racionalizimit të shpenzimeve publike.

Pas nivelit prej **5,453,454 €** në vitin 2026, kjo kategori planifikohet në **4,985,490 €** në vitin 2027 dhe mbetet pothuajse e pandryshuar në vitet 2028 dhe 2029, me **4,987,490 €**.

Ky planifikim reflekton një politikë të kujdesshme fiskale, me fokus në optimizimin e shpenzimeve operative, pa cenuar cilësinë e shërbimeve komunale.

Shpenzimet komunale

Shpenzimet komunale planifikohen në nivel prej **1,157,240 €** për secilin nga vitet **2027, 2028** dhe **2029**, duke mbetur të pandryshuara gjatë gjithë periudhës afatmesme.

Ky nivel i planifikimit garanton mbulimin e obligimeve për energjinë elektrike, ujin, ngrohjen, telekomunikimin dhe shërbimet tjera komunale të institucioneve komunale.

Subvencionet dhe transferet

Subvencionet dhe transferet paraqesin një instrument të rëndësishëm për mbështetjen e zhvillimit ekonomik, bujqësisë, sportit, kulturës, mirëqenies sociale dhe organizatave të ndryshme.

Në vitin 2026 kjo kategori ishte planifikuar në **1,362,502 €**, ndërsa në vitin 2027 rritet ndjeshëm në **1,930,626 €**, kryesisht për shkak të rritjes së mbështetjes për sektorin e bujqësisë dhe politikave zhvillimore komunale.

Në vitet 2028 dhe 2029 subvencionet stabilizohen në nivelin prej **1,649,426 €**, duke reflektuar një planifikim më të balancuar dhe të qëndrueshëm.

Shpenzimet kapitale


Shpenzimet kapitale vazhdojnë të përbëjnë prioritetin kryesor të zhvillimit komunal gjatë periudhës afatmesme.

Në vitin 2026 kjo kategori është planifikuar në **12,707,974 €**, ndërsa në vitin 2027 rritet në **14,565,180 €**, në vitin 2028 në **16,805,032 €**, ndërsa në vitin 2029 arrin në **19,103,930 €**.

Rritja e vazhdueshme e investimeve kapitale dëshmon orientimin strategjik të komunës drejt realizimit të projekteve infrastrukturore dhe zhvillimore në fushat e:

- infrastrukturës rrugore;
- furnizimit me ujë dhe kanalizimit;
- objekteve arsimore dhe shëndetësore;
- sportit dhe kulturës;
- mbrojtjes së mjedisit;
- zhvillimit rural dhe bujqësisë;
- shërbimeve publike dhe projekteve të tjera me interes publik.

Pesha e investimeve kapitale në buxhetin komunal rritet vazhdimisht gjatë periudhës afatmesme, duke dëshmuar orientimin e komunës drejt investimeve afatgjata dhe zhvillimit të qëndrueshëm.


Grafikoni 3: Tendenca e Shpenzimeve Agregate 2025-2029

Grafikoni paraqet strukturën e planifikuar të shpenzimeve komunale sipas kategorive ekonomike për periudhën 2025-2029. Gjatë kësaj periudhe vërehet një rritje graduale e buxhetit total, nga **40,924,714 €** në vitin 2025 në **48,594,579 €** në vitin 2029. Pjesën më të madhe të buxhetit e zënë **pagat dhe mëditjet**, të cilat rriten nga **20.14 milionë €** në **21.70 milionë €**, duke reflektuar ruajtjen e nivelit të punësimit dhe efektet e politikave të pagave në sektorin publik. **Shpenzimet kapitale** paraqesin kategorinë me rritjen më të theksuar, nga **13.17 milionë €** në vitin 2025 në **19.10 milionë €** në vitin 2029, duke dëshmuar orientimin e komunës drejt investimeve në infrastrukturë dhe zhvillim lokal. Ndërkohë, **mallrat dhe shërbimet, shpenzimet komunale** si dhe **subvencionet dhe transferet** mbesin në nivele relativisht të qëndrueshme, duke siguruar funksionimin normal të administratës dhe ofrimin e shërbimeve publike. Në tërësi, struktura e shpenzimeve pasqyron një planifikim të balancuar, ku krahas mbulimit të shpenzimeve operative, një rëndësi e veçantë i kushtohet financimit të investimeve kapitale dhe zhvillimit të qëndrueshëm të Komunës së Pejës.

Shpenzimet Komunale sipas Sektorëve - Vlerësimi i Hershëm për vitin 2027

Grafikoni 4 paraqet shpërndarjen e planifikuar të buxhetit të Komunës së Pejës sipas sektorëve (drejtorive) për vitin 2027, bazuar në vlerësimin e hershëm të buxhetit.

Grafikoni 4:Plani i shpenzimeve sipas sektorëve për 2027



Grafikoni paraqet shpërndarjen e planifikuar të buxhetit sipas sektorëve për vitin **2027**. Pjesa më e madhe e buxhetit është e orientuar në Arsimin Parauniversitar, i cili përfshin rreth **36%** të totalit të shpenzimeve, pasuar nga Shërbimet Publike dhe Mbrojtja Civile me rreth **27%** dhe Shëndetësia Primare me rreth **11%**. Administrata dhe Personeli përfaqësojnë rreth **8%** të buxhetit, ndërsa pjesa tjetër shpërndahet ndërmjet drejtorive të tjera, si Bujqësia, Kultura, Rinia dhe Sporti, Buxheti dhe Financat, Planifikimi Urban, Zhvillimi Ekonomik, Kadastra, Zyra Komunale për Komunitete, Inspekcioni, Zyra e Kryetarit, Zyra e Kuvendit, Prokurimi dhe Teatri i Qytetit. Kjo strukturë e shpërndarjes së buxhetit reflekton prioritetet strategjike të Komunës së Pejës, duke i dhënë përparësi arsimit, shërbimeve publike dhe sektorit të shëndetësisë, si fushat me ndikimin më të madh në ofrimin e shërbimeve për qytetarët.

Struktura e shpenzimeve sipas programeve komunale

Analiza e shpërndarjes së buxhetit sipas programeve komunale tregon se pjesa më e madhe e burimeve financiare vazhdon të orientohej në sektorët që ofrojnë shërbimet bazë për qytetarët.

Programi i **Arsimit Parauniversitar** mbetet përfituesi më i madh i buxhetit komunal, me mbi **15.9 milion €** në vitin 2027, duke reflektuar rëndësinë strategjike të arsimit dhe numrin e madh të punonjësve në këtë sektor.

Një pjesë e konsiderueshme e buxhetit është planifikuar edhe për **Shërbimet Publike dhe Mbrojtjen Civile**, ku investimet rriten nga **11.8 milion €** në vitin 2027 në mbi **14.7 milion €** në vitin 2029, kryesisht si rezultat i zgjerimit të investimeve infrastrukturore.

Edhe **Shëndetësia Primare** vazhdon të financohet në mënyrë të qëndrueshme, me mbi **5 milion €** në vit, duke garantuar ofrimin e shërbimeve shëndetësore primare për qytetarët.

Rritje të konsiderueshme të investimeve janë planifikuar gjithashtu në sektorët e **Bujqësisë, Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Administratës, Buxhetit dhe Financave, Planifikimit Urban**, si dhe në projektet për komunitetet dhe zhvillimin ekonomik lokal.

Në përgjithësi, planifikimi i shpenzimeve për periudhën **2027-2029** është ndërtuar mbi parimet e **qëndrueshmërisë fiskale, planifikimit realist** dhe **orientimit zhvillimor**. Struktura buxhetore siguron një ekuilibër ndërmjet financimit të shpenzimeve operative dhe rritjes së vazhdueshme të investimeve kapitale, duke garantuar ofrimin e shërbimeve publike cilësore dhe realizimin e prioritetëve strategjike të Komunës së Pejës.

Tabela nr.4 Shperndarja sipas kategorive ekonomike në nënprograme 2027-2029

Drejtoria / Programi / Kat. Ekon.	Realizimiimi 2025	Buxheti I planifikuar 2026	Vlerësim i Hershëm 2027	Vlerësim i Hershëm 2028	Vlerësim i Hershëm 2029
Zyra e Kryetarit	613,885.86	598,239.66	576,091.99	576,142.61	577,399.47
Nr. i punëtorëve	19	21	21	21	21
Paga dhe mëditje	222,925.55	243,739.66	249,923.99	251,174.61	252,431.47
Paga dhe mëditje rezerva	0	0	0	0	0
Mallra dhe shërbime	72,481.31	72,500.00	67,000.00	67,000.00	67,000.00
Komunali	0	0	0	0	0
Subvencione dhe transfere	318,479.00	282,000.00	259,168.00	257,968.00	257,968.00
Shpenzime Kapitale	0	0	0	0	0
Administrata dhe Personeli	3,186,344.84	3,173,243.25	3,723,622.13	3,456,443.75	3,259,279.46
Nr. i punëtorëve	57	59	59	59	59
Paga dhe mëditje	456,129.31	539,743.25	564,322.13	567,143.75	569,979.46
Paga dhe mëditje -rezerva	0	0	0	0	0
Mallra dhe shërbime	2,320,957.86	2,326,000.00	2,311,800.00	2,311,800.00	2,311,800.00
Komunali	122,496.67	117,500.00	117,500.00	117,500.00	117,500.00
Subvencione dhe transfere	6,680.00	10,000.00	10,000.00	10,000.00	10,000.00
Shpenzime Kapitale	280,081.00	180,000.00	720,000.00	450,000.00	250,000.00
Inspekcioni	322,017.86	367,825.91	387,343.13	388,909.85	390,484.40
Nr. i punëtorëve	24	27	27	27	27
Paga dhe mëditje	250,901.86	285,325.91	313,343.13	314,909.85	316,484.40
Paga dhe mëditje- rezerva	0	0	0	0	0
Mallra dhe shërbime	71,116.00	82,500.00	74,000.00	74,000.00	74,000.00
Komunali	0	0	0	0	0
Subvencione dhe transfere	0	0	0	0	0
Shpenzime Kapitale	0	0	0	0	0
Prokurimi	38,841.60	41,282.94	42,341.40	42,548.11	42,755.85
Nr. i punëtorëve	4	4	4	4	4
Paga dhe mëditje	37,893.60	40,282.94	41,341.40	41,548.11	41,755.85
Paga dhe mëditje- rezerva	0	0	0	0	0
Mallra dhe shërbime	948.00	1,000.00	1,000.00	1,000.00	1,000.00
Komunali	0	0	0	0	0
Subvencione dhe transfere	0	0	0	0	0
Shpenzime Kapitale	0	0	0	0	0
Zyra e Kuvendit	301,565.03	455,993.20	427,800.00	429,719.00	431,647.60
Nr. i punëtorëve	35	35	35	35	35
Paga dhe mëditje	258,488.53	411,993.20	383,800.00	385,719.00	387,647.60
Paga dhe mëditje- rezerva	0	0	0	0	0

Mallra dhe shërbime	43,076.50	44,000.00	44,000.00	44,000.00	44,000.00
Komunali	0	0	0	0	0
Subvencione dhe transfere	0	0	0	0	0
Shpenzime Kapitale	0	0	0	0	0
Buxhet dhe financa	2,132,636.49	1,019,899.72	1,036,382.06	1,188,073.97	1,889,774.34
Nr. i punëtorëve	30	34	34	34	34
Paga dhe mëditje	264,506.41	323,796.72	338,382.06	340,073.97	341,774.34
Paga dhe mëditje- rezerva	0	0	0	0	0
Mallra dhe shërbime	56,368.09	62,269.49	48,000.00	48,000.00	48,000.00
Komunali	0	0	0	0	0
Subvencione dhe transfere	0	0	0	0	0
Shpenzime Kapitale	1,811,761.99	633,833.51	650,000.00	800,000.00	1,500,000.00
Shërbime Publike, Mbrojtja Civile	9,387,681.25	9,450,262.08	11,765,347.09	12,114,371.01	14,737,526.70
Nr. i punëtorëve	52	55	55	55	55
Paga dhe mëditje	517,862.08	604,887.08	634,327.58	637,499.21	640,686.70
Paga dhe mëditje- rezerva	0	0.00	0	0	0
Mallra dhe shërbime	1,138,733.82	1,174,023.00	1,011,300.00	1,011,300.00	1,011,300.00
Komunali	455,482.08	530,540.00	535,540.00	535,540.00	535,540.00
Subvencione dhe transfere	0	0	0	0	0
Shpenzime Kapitale	7,275,603.27	7,140,812.00	9,584,179.51	9,930,031.80	12,550,000.00
Zyra Komunale për Komunitete	606,423.94	290,287.62	386,943.44	239,340.66	239,739.86
Nr. i punëtorëve	7	8	8	8	8
Paga dhe mëditje	60,131.47	76,787.62	79,443.44	79,840.66	80,239.86
Paga dhe mëditje- rezerva	0	0	0	0	0
Mallra dhe shërbime	12,435.27	13,500.00	7,500.00	9,500.00	9,500.00
Komunali	0	0	0	0	0
Subvencione dhe transfere	0	0	0	0	0
Shpenzime Kapitale	533,857.20	200,000.00	300,000.00	150,000.00	150,000.00
Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvillimi Rural	1,066,907.03	1,285,409.64	1,889,492.00	1,205,579.46	1,206,672.36
Nr. i punëtorëve	21	23	23	23	23
Paga dhe mëditje	168,025.25	192,409.64	217,492.00	218,579.46	219,672.36
Paga dhe mëditje- rezerva	0	0	0	0	0
Mallra dhe shërbime	61,175.93	93,000.00	72,000.00	72,000.00	72,000.00
Komunali	0	0	0	0	0
Subvencione dhe transfere	337652.63	497984.51	1100000	815000	815000
Shpenzime Kapitale	500,053.22	502,015.49	500,000.00	100,000.00	100,000.00
Zhvillimi Ekonomik	436,927.84	340,557.17	286,446.50	391,788.73	392,132.68
Nr. i punëtorëve	6	6	6	6	6
Paga dhe mëditje	69,238.05	67,271.17	68,446.50	68,788.73	69,132.68

Paga dhe mëditje- rezerva		0	0	0	0
Mallra dhe shërbime	37,869.80	22,000.00	18,000.00	18,000.00	18,000.00
Komunali	0	0	0	0	0
Subvencione dhe transfere	99,684.79	100,000.00	100,000.00	105,000.00	105,000.00
Shpenzime Kapitale	230,135.20	151,286.00	100,000.00	200,000.00	200,000.00
Kadastra, Gjeodezia dhe Pronë	200,834.27	240,723.53	254,788.94	256,032.89	257,283.05
Nr. i punëtorëve	22	23	23	23	23
Paga dhe mëditje	196,597.50	234,723.53	248,788.94	250,032.89	251,283.05
Paga dhe mëditje- rezerva	0	0	0	0	0
Mallra dhe shërbime	4,236.77	6,000.00	6,000.00	6,000.00	6,000.00
Komunali	0	0	0	0	0
Subvencione dhe transfere	0	0	0	0	0
Shpenzime Kapitale	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Planifikimi Urban dhe Mjedisi	288,104.64	279,446.16	303,193.02	553,878.98	504,568.38
Nr. i punëtorëve	10	12	12	12	12
Paga dhe mëditje	107,322.67	128,446.16	137,193.02	137,878.98	138,568.38
Paga dhe mëditje- rezerva	0	0	0	0	0
Mallra dhe shërbime	14,934.97	16,000.00	16,000.00	16,000.00	16,000.00
Komunali	0	0	0	0	0
Subvencione dhe transfere	0	0	0	0	0
Shpenzime Kapitale	165,847.00	135,000.00	150,000.00	400,000.00	350,000.00
Shëndetësia Primare dhe administr	4,872,299.73	5,095,543.75	4,948,106.14	5,028,182.72	5,298,359.69
Nr. i punëtorëve	348	364	364	364	364
Paga dhe mëditje	3,756,924.67	4,109,351.75	4,015,316.14	4,035,392.72	4,055,569.69
Paga dhe mëditje- rezerva	0	0	0	0	0
Mallra dhe shërbime	520,922.28	517,192.00	413,790.00	413,790.00	413,790.00
Komunali	160,997.78	156,000.00	156,000.00	156,000.00	156,000.00
Subvencione dhe transfere	60,000.00	63,000.00	63,000.00	63,000.00	63,000.00
Shpenzime Kapitale	373,455.00	250,000.00	300,000.00	360,000.00	610,000.00
Shërbimet Sociale dhe Rezidenciale	642,559.63	733,089.62	704,008.19	675,257.23	676,512.51
Nr. i punëtorëve	18	31	31	31	31
Paga dhe mëditje	144,405.36	240,400.62	249,808.19	251,057.23	252,312.51
Paga dhe mëditje- rezerva	0	0	0	-	-
Mallra dhe shërbime	61,252.53	61,700.00	59,000.00	59,000.00	59,000.00
Komunali	29,600.00	25,200.00	25,200.00	25,200.00	25,200.00
Subvencione dhe transfere	89700	90,000.00	90,000.00	90,000.00	90,000.00
Shpenzime Kapitale	317601.74	315,789.00	280,000.00	250,000.00	250,000.00

Kulturë, Rini dhe Sport	1,083,458.61	1,262,487.17	1,148,477.97	1,380,096.20	2,145,652.58
Nr. i punëtorëve	34	35	35	35	35
Paga dhe mëditje	278,553.54	313,134.17	323,645.97	325,264.20	326,890.52
Paga dhe mëditje- rezerva	0	0	0	0	0
Mallra dhe shërbime	59,076.60	76,000.00	91,000.00	91,000.00	91,000.00
Komunali	76,500.00	78,000.00	78,000.00	78,000.00	78,000.00
Subvencione dhe transfere	306,930.00	269,870.00	255,832.00	255,832.00	255,832.00
Shpenzime Kapitale	362,398.47	525,483.00	400,000.00	630,000.00	1,393,930.06
Teatri I qytetit	219,720.17	267,372.19	296,582.18	297,714.46	298,852.41
Nr. i punëtorëve	15	22	22	22	22
Paga dhe mëditje	158,448.26	195,021.19	226,456.18	227,588.46	228,726.41
Paga dhe mëditje- rezerva	0	0	0	0	0
Mallra dhe shërbime	16,588.29	17,704.00	12,500.00	12,500.00	12,500.00
Komunali	5,483.62	5,000.00	5,000.00	5,000.00	5,000.00
Subvencione dhe transfere	39,200.00	49,647.00	52,626.00	52,626.00	52,626.00
Shpenzime Kapitale	0	0	0	0	0
Arsimi Parauniversitar	15,524,504.75	17,052,175.39	15,942,711.82	17,963,657.37	16,245,937.66
Nr. i punëtorëve	1479	1463	1463	1463	1463
Paga dhe mëditje	13,187,071.18	13,315,354.39	13,389,111.82	13,456,057.37	13,523,337.66
Paga dhe mëditje- rezerva	0	0	0	0	0
Mallra dhe shërbime	827,196.83	868,065.62	732,600.00	732,600.00	732,600.00
Komunali	190,174.20	195,000.00	240,000.00	240,000.00	240,000.00
Subvencione dhe transfere	0	0	0	0	0
Shpenzime Kapitale	1,320,062.54	2,673,755.38	1,581,000.00	3,535,000.00	1,750,000.00
QB 2027/01					
Totali	40,924,713.54	41,953,839.00	44,119,678.00	46,187,737.00	48,594,579.00
Nr. i punëtorëve	2181	2222	2222	2222	2222
Paga dhe mëditje	20,135,425.29	21,322,669.00	21,481,142.49	21,588,549.20	21,696,492.94
Rezerva	0	0	0	0	0
Mallra dhe shërbime	5,319,370.85	5,453,454.11	4,985,490.00	4,987,490.00	4,987,490.00
Komunali	1,040,734.35	1,107,240.00	1,157,240.00	1,157,240.00	1,157,240.00
Subvencione dhe transfere	1,258,326.42	1,362,501.51	1,930,626.00	1,649,426.00	1,649,426.00
Shpenzime Kapitale	13,170,856.63	12,707,974.38	14,565,179.51	16,805,031.80	19,103,930.06
Totali	40,924,713.54	41,953,839.00	44,119,678.00	46,187,737.00	48,594,579.00
Vitet	2025	2026	2027	2028	2029

3.5. Politikat e reja

Të hyrat komunale në periudhën afatmesme (2027-2029)

Në kuadër të planifikimit afatmesëm financiar, Komuna e Pejës ka paraparë një rritje graduale dhe të qëndrueshme të Të Hyrave Vetanake Komunale (THVK), si rezultat i reformave të vazhdueshme fiskale të ndërmarra nga niveli qendror dhe implementimit të kornizës së re ligjore për financat lokale.

Një nga shtyllat kryesore të këtij planifikimi është **Tatimi në Pronën e Paluajtshme (përfshirë Tokën)**. Pas kalimit të fazave fillestare të vlerësimit dhe faturimit progresiv, periudha afatmesme 2027-2029 do të karakterizohet nga zbatimi i plotë i reformës së re të Tatimit në Pronë (sipas ndryshimeve të fundit ligjore), e cila përfshin aplikimin e shkallëve të reja tatimore të bazuara në vlerën e tregut dhe rritjen e shkallës së inkasimit për tokat bujqësore, komerciale dhe industriale. Ky zhvillim përfaqëson një hap kritik drejt forcimit të autonomisë fiskale të Komunës së Pejës, duke siguruar një burim të parashikueshëm dhe të qëndrueshëm financimi që do të orientohej drejtpërdrejt në përmirësimin e shërbimeve publike dhe rritjen e kapaciteteve investuese lokale.

Për vitet e kornizës afatmesme 2027-2029, të hyrat nga **gjobat në trafik dhe ato të shqiptuara nga gjykatat** do të vazhdojnë të grumbullohen në llogarinë e komunës në përputhje me udhëzimet e përcaktuara nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve. Komuna e Pejës ka integruar sistemet e përditësuara të ndarjes automatike të këtyre të hyrave (përfshirë gjobat e agjencive qendrore që ekzekutohen në territorin e komunës), duke synuar rritjen e efikasitetit në mbledhjen e tyre dhe eliminimin e vonesave në alokim.

Në aspektin makroekonomik, si niveli qendror ashtu edhe ai komunal në Republikën e Kosovës po përballen me sfida të theksuara strukturore dhe sociale. Këto sfida janë të ndikuara nga presionet inflacioniste globale, fluktucionet në tregun e energjisë, si dhe ndryshimet në zinxhirët e furnizimit që kanë reflektuar rritje të kostove të realizimit të projekteve kapitale dhe rritje të kostos së jetesës për qytetarët. Në këtë kontekst, Komuna e Pejës, duke ndjekur udhëzimet e Qarkores Buxhetore 2027/01, ka aplikuar masa të kujdesit fiskal, duke prioritetizuar mbulimin e plotë të obligimeve kontraktuale, skemave sociale dhe shërbimeve esenciale, me qëllim të ruajtjes së stabilitetit financiar në nivel lokal.

Në përputhje me këtë kornizë, zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik i zonave me potencial të lartë (si zonat turistike të Rugovës dhe Dukagjinit) dhe promovimi i investimeve të drejtpërdrejta mbeten prioritetet strategjike kryesore të Komunës së Pejës. Përmes shfrytëzimit efikas të rritjes së Grantit të Përgjithshëm dhe rritjes progresive të të hyrave vetanake, komuna synon të stimulojë partneritetet publiko-private, të zgjerojë infrastrukturën mbështetëse për turizëm dhe biznes, dhe të krijojë vende të reja pune, duke garantuar kështu rritjen e mirëqenies së përgjithshme të komunitetit në periudhën 2027-2029.

Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

Buxhetimi i Përgjegjshëm Gjinnor (BPGj)

Objektivi Kryesor:

Promovimi i barazisë gjinnore dhe fuqizimi ekonomik i grave në sektorin e bujqësisë dhe zhvillimit rural do të implementohet përmes integritit të plotë të Buxhetit të Përgjegjshëm Gjinnor (BPGj) në kuadër të skemave mbështetëse të komunës. Për periudhën afatmesme **2027-2029**, Komuna e Pejës synon rritjen progresive të përqindjes së alokimeve financiare nga kategoria e *Subvencioneve dhe Transfereve* për gratë fermere (me theks të veçantë te gratë kryefamiljare dhe ato vetushqyese), duke siguruar gjithëpërfshirje, rritje të konkurrueshmërisë dhe qëndrueshmëri të bizneseve rurale të udhëhequra nga gratë.

Treguesit e Matshëm të Performancës (Indikatorët e Inputit dhe Outputit):

- **Përqindja e buxhetit të alokuar:** Rritja vjetore (në përqindje) e vlerës monetare të subvencioneve të transferuara direkt te gratë përfituese në raport me buxhetin total të ndarë për thirrjet bujqësore.
- **Regjistrimi i pronësisë:** Rritja e numrit të grave të regjistruara si bartëse të Niveleve tëngasjes Bujqësore (Fermere me Numër Unik të Fermës - NUIF) dhe si pronare legjitime të bizneseve të rregullta bujqësore (Agrobiznese).
- **Ndërmarrësia e re rurale:** Numri i bizneseve të reja fillestare (*start-up*) në sektorin e përpunimit të ushqimit dhe agroturizmit të themeluara dhe të menaxhuara nga gratë, të përkrahura me grante komunale.

Shpjegim dhe Rëndësia e Treguesve:

Ky set indikatorësh është dizajnuar në përputhje me udhëzimet e Qarkores Buxhetore 2027/01 për monitorimin e performancës me bazë gjinnore. Ndjekja sistematike e këtyre treguesve i mundëson Komunës së Pejës të matë ndikimin real të parasë publike në eliminimin e mospërputhjeve gjinnore në zonat rurale, duke ofruar të dhëna të ndara sipas gjinisë të cilat kërkohen nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve gjatë vlerësimit të kodeve programore.

Masa dhe Veprime të Propozuara për Arritjen e Objektivave (2027-2029):

- **Zbatimi i Masave Afirmative në Rregullore:** Rishikimi i kritereve të rregullores komunale për ndarjen e subvencioneve, duke aplikuar pikë shtesë apo kuota specifike për aplikacionet ku gratë janë bartëse të projektit apo pronare të tokës. **Ngritja e Kapaciteteve dhe Trajnimit e Targetuara:** Organizimi i programeve të trajnimit teknik dhe mentorimit në menaxhim financiar, të financuara nga kategoria e *Mallrave dhe Shërbimeve*, për t'i përgatitur gratë në aplikimin e teknologjive të reja operative dhe aplikimeve digjitale për grante.
- **Thjeshtimi i Procedurave Administrative:** Lehtësimi i qasjes në aplikime përmes eliminimit të barrierave burokratike dhe ofrimit të asistencës teknike direkte pranë zyrave të Drejtorisë gjatë fazës së thirrjeve publike.
- **Rrjetëzimi dhe Partneriteti:** Mbështetja e shoqatave dhe kooperativave bujqësore të grave për të lehtësuar qasjen e tyre në tregun lokal dhe rajonal, duke promovuar produktet e tyre përmes panairëve të financuara nga komuna.
- **Auditimi Gjinnor i Buxhetit:** Monitorimi i vazhdueshëm i ekzekutimit të buxhetit dhe raportimi periodik mbi përparimin e treguesve të përcaktuar, duke mundësuar rishikimin dhe përshtatjen e politikave në dëgjimet e ardhshme buxhetore në varësi të rezultateve të arritura.

Nëpërmjet këtyre veprimeve, Komuna e Pejës siguron që planifikimi afatmesëm buxhetor jo vetëm që përmbush kriteret ligjore të Republikës së Kosovës për barazi gjinore, por shndërrohet në një motor të zhvillimit të qëndrueshëm, socio-ekonomik dhe gjithëpërfshirës të të gjithë komunitetit rural.

Shtojca - Investimet Kapitale 2027-2029

	Emri i Projektit	Vitin 2026	Vitin 2027	Viti 2028	2029
	1	2	3	4	4
	16319- Administratë dhe Personeli				
1	Blerja dhe instalimi i pompes termike për objekt të Administrates	80,000.00	120,000.00	150,000.00	250,000.00
2	Ndërtimim i objektit të Administrates në hapësirat e ish Urbanizmit (Arsim, Urbanizëm, Sherbime Publike, Kultur)	390,000.00	600,000.00	300,000.00	0.00
	Total Administratë dhe Personeli	470,000.00	720,000.00	450,000.00	250,000.00
	175190 - Buxhet dhe financa				
3	Participim me Ministrit e Linjës dhe donator	635,000.00	650,000.00	800,000.00	1,500,000.00
4	Ndertimi i rruges Haxhaj - Stankaj	90,386.65	0.00	0.00	0.00
5	Ndertimi i rruges Bajr-Ymeraj	226,066.36	0.00	0.00	0.00
6	Rregullimi dhe asfaltimi i rruges ekzistuese dhe ndertimi i rru.Tbane	70,020.00	0.00	0.00	0.00
	Total Buxhet e Financa	635,000	650,000	800,000	1,500,000
	18019 - Infrastruktura Rrugore				
7	Ndërt. ujësj. në Stankaj, Bogë, Shkrel, Pepaj, Malaj, Shtupeq i Madh, dhe Kuqishtë	400,000.00	150,000.00	0.00	0.00
8	Ujesjellsis per fshatrat e Lugut te baranit	150,000.00	0.00	0.00	0.00
9	Rindërtimi i murit të lumit dhe mvëshja me gurë	20,000.00	0.00	0.00	0.00
10	Ndërt. i impianteve në Raushiq, Kryshec, Broliq, Trestenik, (Baran, Glllogjan, Nepole), (Nabergjan Katund i Ri)	22,000.00	0.00	300,000.00	200,000.00
11	Asfaltimi i Rruges Sejnove - Gjore faza e dyte	443,109.00	537,368.20	200,000.00	0.00
12	Ndërtimi i Deponisë së mbeturinave në Sferkë	1,000,000.00	2,000,000.00		
13	Regullimi i Shetitores prej Ures se Novoselles - Mulliri Berdynajve			200,000.00	250,000.00
14	Ndërtimi i rrethojave të varrezave ne fshatrat dhe qytet me beton, duhet cekur cilat varreza	80,000.00	79,393.24	0.00	0.00
15	Asfaltimi i anekseve te rrugëve ne fshatrat e Rugoves (Stankaj, Boge, Shkrel)	180,000.00	150,000.00	450,000.00	150,000.00
16	Asfaltimi i anekseve te rrugëve ne fshatrat e Rugoves (Kuqisht, Koshutan, Drelaj, Pepaj)	180,000.00	100,000.00	550,000.00	0.00
17	Asfaltimi i anekseve te rrugëve ne fshatrat e Rugoves (Shtupeq i Madhe, Sh. I Vogel, Malaj)	140,000.00	200,000.00	234,869.00	0.00
18	Ndërtimi dhe regullimi i hapësirave gjelbruese buzë Lumbardhit dhe në lagjen Asllan Çeshme	200,000.00	200,000.00	0.00	0.00
19	Ndertimi i rrugës së Bjeshkës së Jabllanices së Vogel	100,000.00	200,000.00	50,000.00	0.00
20	Ndërtimi i impiantit në Jabllanicë të Leshanit	600,000.00	466,842.70	0.00	0.00

21	Ndërtimi i impiantit në Kuçishte		300,000.00	1,250,000.00	200,000.00
22	Ndërtimi i rruges Bazeni i Madh - Bellopojë	100,000.00	700,000.00	0.00	0.00
23	Ndërtimi i rrugës Poqesst - Doberdol	100,000.00	441,667.60	0.00	
24	Ndërtimi i rrugëve: Jarinje - Burgu - Pro Credit Bank	0.00	0.00	100,000.00	100,000.00
25	Ndërtimi i rrethojave metalike në Varreza ne qytete dhe ne fshatra, duhet cekur cilat varreza	100,000.00	55,021.00	0.00	0.00
26	Ndërtimi i rruges Lipe e Vogel	50,000.00	100,000.00	100,000.00	100,000.00
27	Ndërtimi i rrugës Zagerm-Lubeniç	100,000.00	100,000.00	0.00	0.00
28	Ndërtimi i sheshit prej Ures së Zallit deri te Ura e re (Hajdaraget)	250,000.00	563,710.27	0.00	0.00
29	Ndërtimi i rruges në zonën industriale në Zahaq, Sfrek dhe Lutogllav	400,000.00	247,000.00	0.00	0.00
30	Ndërtimi i rrugës në Maja e Zezë	50,000.00	242,991.00	200,000.00	0.00
31	Ndërtimi i rrugës në fshatin Dushkaje	100,000.00	490,185.50	100,000.00	0.00
32	Rregullimi i rrugës Leshan - Kerstovc (me Urë)	0.00	0.00	200,000.00	100,000.00
33	Ndërtimi i rruges Transít - Qyshk - Zahaq	0.00	0.00	400,000.00	200,000.00
34	Ndërtimi për ndriçim publik me panele solare në Sferk, Lutogllavë dhe Gorozhdec	800,000.00	300,000.00	0.00	0.00
35	Ndërtimi, renovimi i rrugëve dhe trotualet në Qendër të qytetit, Lagjet Puhovc, Karagaç, Jarine, Xh.Kadë, Spitalit, Kristal dhe 7Shtator	800,000.00	550,000.00	800,000.00	800,000.00
36	Ndërtimi i Kanalizimit në lagjet Kapeshtice,Lagjen e Gurit, Lagjen Kristal, Fshatin Baran	68,680.00	100,000.00	0.00	0.00
37	Ndërtimi i rrugëve në fsh. e Lugut të Baranit, Leshanit, Trestenikut dhe Radacit (podgurit)	1,205,000.00	400,000.00	0.00	0.00
38	Ndërtimi i shtigjeve dhe hapësirave të tjera ndimëse në Parkun e Pishave	0.00	200,000.00	0.00	0.00
39	Ndërtimi i rrugës Qafë Hajle-Varri i Sykut	100,000.00	250,000.00	240,000.00	0.00
40	Rregullimi i infrastrukturës publike në zonat industriale të Brestovikut, Sferkës, Zahaqit, Lugun e Baranit, Lugun e Leshanit, Podgurit, Rugovë, Lipë, Qendra Zejtare, Rrokaqielli dhe 7	100,000.00	0.00	0.00	0.00
41	Ndërtimi i sheshit " Haxhi Zeka "	0.00	100,000.00	900,000.00	800,000.00
42	Ndërtimi i trafos ne Qerdhen dhe shkollen fillore Vitomeric	115,211.00	50,000.00	0.00	0.00
43	Ndërtimi i sheshit " Shkelzen Haradinaj "	0.00	50,000.00	450,000.00	400,000.00
44	Ndërtimi i shetitores nga ura e Kombinatit deri te ura tranzit -kfor	0.00	0.00	572,276.00	
45	Projekte për zhvillim e infrastrukturs	0.00	0.00	2,632,886.80	9,250,000.00
46	Ndërtimi i shtepis se fshatit ne Nabergjan dhe Radavc (Lagja Avdylaj)	80,000.00	10,000.00	0.00	0.00
47	Ndërtimi i ures per automjete "Bukuresht Mahall - Sallhane"		250,000.00	0.00	0.00
	Totali - Infrastruktura Rrugore - Pejë	8,034,000.00	9,584,179.51	9,930,031.80	12,550,000.00

195950 - Zyra komunale për r komunitete dhe kthim					
49	Ndertimi i rrugeve dhe ndriqimi ne fsh. Zllopek,Goroshdevc, Brestovik dhe Vitomeric	180,000.00	250,000.00	150,000.00	150,000.00
49	Ndertimi i rruges ne fshatin Levoshe	20,000.00	50,000.00		
	Total Zyra komunale për komunitete dhe kthim	200,000.00	300,000.00	150,000.00	150,000.00
470190 - Bujqësi					
50	Ndërtimi kanaleve të ujitjes në regjionin e lugut të Baranit,Trestenikut, Leshanit, Podgurit dhe Fusha e Pejes	500,000.00	500,000.00	100,000.00	100,000.00
	Total Bujqësi	500,000.00	500,000.00	100,000.00	100,000.00
480190 - Planifikimi dhe Zhvillimi Ekonomik					
51	Projekte te zhvillimit ekonomik		100,000.00	200,000.00	200,000.00
52	Ndertimi i Zipline në zonën e Podgurit	86,749.00	0.00	0.00	0.00
53	Ndertimi i Muzeut te Bjeshkatarise afër Kishës katolike	64,537.00	0.00	0.00	0.00
	Total Planifikimi dhe Zhvillimi Ekonomik	151,286.00	100,000.00	200,000.00	200,000.00
661000 - Planifikimi Hapsinor dhe Rregullativ					
54	Gjelbrimi i hapesires te Sharra, Tranzit-Qyshk buz Lumbardhit dhe Ura e Gurit-Duli	35,000.00	50,000.00	50,000.00	50,000.00
55	Ndertimi i kanalit të hapur atmosferik ekzistues të Seravisë, Katund i Ri, dhe kanalit të hapur	100,000.00	100,000.00	350,000.00	300,000.00
	Total Planifikimi Hapsinor dhe Rregullativ	135,000.00	150,000.00	400,000.00	350,000.00
741000 - Shërbimet e shëndetësisë primare					
56	Ndërtimi i qendres multifunksionale të trajnimeve faza 2 në lagjen 2Korriku	140,000.00	0.00	0.00	0.00
57	Ndërtimi i QMFsë në Dardani	50,000.00	250,000.00	0.00	0.00
58	Blerja e paisjeve mjekesore aparat Radiologjik, Ortopan, aparat oksigjen formuese dhe autokllav	60,000.00	0.00	60,000.00	60,000.00
59	Ndertimi i Objektit te ri te QKMF-se	0.00	0.00	250,000.00	500,000.00
60	Rindërtimet në QKMF dhe degët e saj	0.00	0.00	50,000.00	50,000.00
	Total Shërbimet e shëndetësisë primare	250,000.00	250,000.00	360,000.00	610,000.00
755920 - Shërbimet Rezidenciale					
61	Ndërtimi i objektit për persona me aftësi të kufizuar në Vitomericë	0.00	0.00	0.00	0.00
62	Financimi për shtëpitë e komunitetit për personat me aftësi të kufizuar		0.00	0.00	0.00
63	Shtepia per mbrojtjen e femijeve	85,789.00	50,000.00	50,000.00	50,000.00
64	Financimi për shtëpitë e komunitetit për persona të moshuar	230,000.00	230,000.00	200,000.00	200,000.00
	Total Shërbimet Rezidenciale	315,789.00	280,000.00	250,000.00	250,000.00

85019- Kultur Rini dhe Sport					
65	Ndërtimi i palestres në Zahaq	200,000.00	200,000.00	0.00	0.00
66	Ndërtimi i palestrës së ish Partizanit për sportet luftarake dhe atletike	80,000.00	0.00	500,000.00	500,000.00
67	Ndërtimi i Palestres së basketbollit në Lagjen Karagaq (bashkëfinancim me F.B	50,000.00	70,000.00	130,000.00	100,000.00
68	Ndërtimi I teatrit Istref Begolli	200,000.00	50,000.00	0.00	0.00
69	Rindërtimi i fushe e hapur " Valon Begolli"	0.00	80,000.00	0.00	30,000.00
70	Ndërtimi i bibliotekës së Qytetit	0.00		0.00	763,930.06
	Total Kultur Rini dhe Sport	530,000.00	400,000.00	630,000.00	1,393,930.06
92095 -Arsim dhe Shkencë					
71	Ndërtimi i shkollës Ekonomike	0.00	0.00	800,000.00	0.00
72	Ndërtimi i shkollës fillore ne fsh. Llozhan	150,000.00	631,000.00	300,000.00	0.00
73	Ndërtimi I shkolles fillore ne fsh. Loxhe	0.00	0.00	1,100,000.00	0.00
74	Ndërtimi i qerdhes ne fsh Zahaq dhe Stacioni i Trenit	0.00	0.00	0.00	800,000.00
75	Ndërtimi i Palestrës së sportive në shkollen Smajl Hajdaraj	0.00	0.00	0.00	500,000.00
76	Ndërtimi i Palestrës së sportive në shkollen ne fsh . Gilloxhan		200,000.00	250,000.00	50,000.00
77	Rindërtimi i Shkollave dhe Anekseve ne Nabergjan, Llozhan, Terstenik, Lidhja e Prizrenit, Ramiz Sadiku, Qyshk, Zahaq, Nabergjan dhe rrethoja ne Hil Mosi Jabllanice	300,000.00	200,000.00	350,000.00	300,000.00
78	Ndërtimi I palestres së Sportit në Trstenik	200,000.00	200,000.00	0.00	0.00
79	Ndërtimi I palestres së sportive në Kryshec		100,000.00	400,000.00	0.00
80	Blerja e kombibusave për shkolla -	235,000.00	141,159.87	235,000.00	0.00
81	Inventar per shkolla	75,000.00	50,000.00	100,000.00	100,000.00
82	Ndërtimi i Gjinnazit	2,000,000.00	108,840.13	0.00	0.00
	Total Arsim dhe Shkencë	2,960,000.00	1,631,000.00	3,535,000.00	1,750,000.00
		14,181,075.00	14,565,179.51	16,805,031.80	19,103,930.06



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA PEĆ



KUVENDI I KOMUNËS PEJË

I. Numër: 01-016/01-38974, datë: 29. Qershor 2026

Në bazë të nenit 11, nenit 12 paragrafi 1, pika d) dhe nenit 24 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 03/L – 040 Për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës, nenit 2. paragrafi 2.1. dhe 2.3. të Ligjit Nr. 03/L – 049 Për Financat e Pushtetit Lokal, Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, dhe nenit 64 dhe nenit 20 paragrafi 1 pika 1.4. të Statutit Nr.01/2020 të Komunës së Pejës, I. Numër: 01-016/01-41341 datë: 30. Shtator 2020, Kuvendi i Komunës Pejë, në Rekomandim të Komitetit për Politikë e Financa në takimin e mbajtur me datë: 29. Qershor 2026, merr këtë:

V E N D I M

Nr. 70/2026

**Mbi aprovimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB) të Komunës së Pejës
për periudhën 2027 - 2029**

1. APROVOHET Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB) e Komunës së Pejës për periudhën 2027 - 2029.
2. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB) për periudhën 2027 - 2029.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Buxhet e Financa i Komunës së Pejës.
1. Ky vendim shpallet tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në Web-faqen e Komunës së Pejës.

Vendimi i dërgohet:

MAPL-së,

MFPT-së,

Kryetarit të Komunës,

DBF-së, Arkiv.



KRYESUESI I KUVENDIT,
z. Rexhep Kurtbogaj